

ANALİZË E SHKURTËR  
**Planifikim urban për qytetarët 3**  
**Autore: Rozafa Basha**  
*Tetor 2014, Prizren*

## PËRMBAJTJA

I. Përbledhja ekzekutive .....	2
II. Hyrje .....	3
III. Projekti për planifikimin me pjesëmarrje .....	6
IV. Metodologjia e hulumtimit .....	7
V. Rezultatet .....	7
VI. Konkludim .....	14
EC Ma Ndryshe.....	19

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshiresh – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren", që përkrahët finanziarisht nga Olof Palme International Center, e cila përkrahët nga Qeveria e Suedisë



## I. Përbledhje ekzekutive

Qyteti është hapësirë kolektive që karakterizohet me pasuri dhe shumëlojshmëri kulturore që iu takojnë të gjithëve<sup>1</sup>. Aiështë produkt i natyrës dhe i natyrës së njeriut në veçanti. Qyteti nuk është thjesht një mekanizëm fizik a konstrukt artificial, sepseai përfshihet në proceset vitale të njerëzve që e përbëjnë atë<sup>2</sup> dhe për këtë ai duhet t'u ofrojë të gjithëve mundësitë e barabarta për t'i gëzuar burimet, pasurinë, shërbimet dhe të mirat e tjera që i ofron. Kjo ndryshe quhet e drejta për qytet, e cila rregullohet përmes Kartës Ndërkombëtare të së Drejtës për Qytet, e miratuar në Forumin Botëror Social në vitin 2004. Mes tjerash, në këtë kartë, kjo e drejtë pëershruhet si e drejtë themelore e se cilët për të shfrytëzuar në mënyrë të barabartë qytetin brenda parimeve të qëndrueshmërisë, demokracisë, barazisë dhe drejtësisë sociale<sup>3</sup>.

E drejta për qytet është term i themeluar nga filozofi dhe sociologu marksist francez Henri Lefevbre në vitin 1968<sup>4</sup>, dhe interpretuar nga filozofi tjetër marksist David Harvey. Mes tjerash, kjo e drejtë ngërthen në vete të drejtën për ta ndërruar veten duke e ndërruar qytetin. Ai këtë të drejtë e sheh si të drejtë të përbashkët, meqë, sipas tij, për ta transformuar duhet

<sup>1</sup>World Charter for the Right to the City, World Social Forum, Porto Alegre 2004, marrë nga [www.urbanreinventors.net/3/wsf.pdf](http://www.urbanreinventors.net/3/wsf.pdf), qasur më 16.12.2014, në 15:00

<sup>2</sup>Ambrose, P. Urban Process Urban Power, London Routledge, 1994, marrë nga <https://urbanmethexis.wordpress.com/tag/urban-imaginary/>, qasur më 16.12.2014

<sup>3</sup>World Charter for the Right to the City, World Social Forum, Porto Alegre 2004, marrë nga [www.urbanreinventors.net/3/wsf.pdf](http://www.urbanreinventors.net/3/wsf.pdf), qasur më 16.12.2014, në 15:00

<sup>4</sup>Lefevbre, H., Le Droit à la Ville, botuar në vitin 1968

ushtruar pushtetin kolektiv mbi proceset e urbanizimit.<sup>5</sup>

Kur flasim për të drejtën për qytet, sipas Peter Marcuse, ajo s'është thjesht vetëm e drejtë për të konsumuar qytetin, por, duke i vazhduar tutje termat e H. Lefevbre-it, është e drejtë për të prodhuar dhe shijuar qytetin<sup>6</sup>. Nuk është vetëm e drejtë për të zgjedhur atë që prodhohet pasi që është prodhuar, por edhe e drejtë për të përcaktuar çka dhe si prodhohet, dhe ç'është më e rëndësishmja, e drejta për të marrë pjesë në prodhimin e saj<sup>7</sup>.

Në frysme të këtij termi është themeluar edhe lëvizja *The Right to the City*<sup>8</sup>, e cila, e nisur fillimisht në SHBA, tashmë është përhapur në disa shtete, dhe, mes tjerash, angazhohet për drejtësi racore, urbane, të drejtat e njeriut dhe demokraci. Kjo lëvizje i ka në spikamë grupet e marginalizuara që rrallëherë gjejnë përfaqësim politik, që anashkalohen nga praktikat institucionale për politikëbërjedhe të cilave hapësira iu krijon bariera dhe pengesa në përditshmëri dhe në pjesëmarrjen aktive në ekonomi dhe shoqëri.<sup>9</sup> Kjo lëvizje thekson se të gjithë kanë të drejtë të kenë kontroll dhe hise në vendimmarrjen mbi planifikim dhe qeverisje

<sup>5</sup>Harvey, D., The Right to the City, New Left Review 53, <http://newleftreview.org/II/53/david-harvey-the-right-to-the-city>, qasur më 16.12.2014, në ora 16:00

<sup>6</sup> Marcuse, P., kapitulli 3, Whose Right(s) to what City?, Cities for People not for Profit: Critical Urban Theory and the Right to the City, ed. Brenner, N., Marcuse, P., Mayer, M., Routledge, New York, 2012, Amazon Kindle edition.

<sup>7</sup>Po aty.

<sup>8</sup><http://righttothecity.org/about/mission-history/>, qasur më 16.12.2014, në ora 16:00

<sup>9</sup> Prince, M., J., Inclusive City Life, Persons with Disability and Politics of Difference, Disability Studies Quarterly, Vol. 28, n.1, <http://dsq-sds.org/article/view/65/65>, qasur më 16.12.2014, në ora 20:00

të qyteteve që i jetojnë dhe në të cilat punojnë; të gjithë kanë të drejtë t'i japid formë dhe t'i projektojnë hapësirat që i banojnë, etj.<sup>10</sup>

Të gjitha këto paraqesin qëllimet themelore të vizonit të qytetit gjithëpërfshirës, në të cilin, përmes largimit të barrierave fizike, shoqërore, kulturore dhe politike për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes në qytet, qytetarëve iu mundësohet që të kontribuojnë dhe komunikojnë aktivisht, të fokusojnë energjinë dhe idetë e tyre për qytetin<sup>11</sup>. Përmes pjesëmarrjes në këto procese, qytetarët do të mund t'iu japid kuptim hapësirave urbane, duke iu bërë vend aktiviteteve të veta brenda kontekstit të tyre<sup>12</sup>, dhe duke e bërë mundur ta prodhojnë hapësirënsi të mirë të përbashkët, me të cilën e lidhin identitetin e vet.

Për t'i vënë në pah shqetësimet e përditshmërisë së qytetarëve të Prizrenit, si dhe për të kuptuar se sa janë të njohur me procesin aktual të planifikimit dhe mundësitë e pjesëmarrjes qytetare në vendimet që lidhen me të, në qershor të këtij viti, u krye anketimi i tretë. Të gjeturat e anketimit u mblohdhën nga një mostër e gjerë e popullatës së Prizrenit. Ky rapport përbledh të gjeturat dhe ofron rekomandime bazuar në problemet më kritike të identikuara në anketim.

## II. Hyrje

(...) çdo qytet (shtet) është një bashkësi dhe se çdo bashkësi krijohet duke pasur një qëllim të mirë, (sepse të gjithë veprojnë për ta arritur atë që u duket atyre se është e mirë). Me t'u vendosur ky qëllim mund të themi se parasëgjithash ai synon dhe piret nga më e mira e gjithë të mirave të asaj bashkësie, që vendos dhe nënkuption në vetvete të gjitha të tjerat, dhe kjo është ajo që quhet qytet dhe bashkësi politike. (Aristoteli, Politika, libri i parë)

Qyteti gjithëpërfshirës promovon zhvillimin e bazuar në barazi dhe drejtësi. Barazia dhe drejtësia për të gjithë janë parimet mbi të cilat duhet të prodhohen qyteti, i cili, sipas Ali Madanipour-it, nënkupton që duhet të jetë vend i qasshëm, i krijuar dhe i menaxhuar përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe demokratike, ndërsa këto të fundit sigurojnë përmirësim të mjedisit fizik dhe zhvillim social.<sup>13</sup> Në të qytetarët duhet të janë të fuqizuar të mbledhin dhe të kontribuojnë me ide, të dhëna dhe propozime të drejtuara vendimmarrësve lokalë, meqë qytetarët janë "ekspertët" e situatës së vet urbane dhe e kanë dijen dhe zgjidhjen për shumë çështje.<sup>14</sup>

Kur flasim për barazi, kemi të bëjmë me mundësinë e qasjes për të gjithë, si parim që duhet ta mishërojë një qytet gjithëpërfshirës. Së këndejmi, ai duhet të jetë i qasshëm në mënyrë të barabartë nga të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh aftësitë e tyre fizike, moshën, gjininë, orientimin seksual, etninë, nivelin e të ardhurave dhe statusin social.

<sup>10</sup><http://righttothecity.org/about/mission-history/>, qasur më 16.12.2014, në ora 16:00

<sup>11</sup>Urban Trends: A glossary of Ideas from the BMW Guggenheim Lab, marrë nga

<http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/>, qasur më 16.12.2014, në ora 21:00

<sup>12</sup><https://urbanmethexis.wordpress.com/tag/urban-imaginary/>, qasur më 16.12.2014, në ora 16:00

<sup>13</sup>Madanipour, A., Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development, fq.2, Madanipur, A., ed., Routledge, New York, 2010, Amazon Kindle edition

<sup>14</sup>Urban trends, BMW Guggenheimlab, <http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/#!new-york-city>, (qasur më 10.12.2014, ora 14:00)

Barazinë shpeshherë e gjejmë të njëjtësuar ose përbrenda termit drejtësi sociale, që në njëren anë nënkuption mundësitë e barabarta që i ofrohen të gjithëve në shoqëri, ndërsa në anën tjetër përkufizohet si ajo që "...promovon shoqëri të drejtë, duke i sfiduar padrejtësitë dhe duke e vlerësuar diversitetitit"<sup>15</sup>.

Sot, në epokën e shqetësimeve që lidhen me ndotjen e mjedisit, burimet në zhdukje të energjisë, numrime madhe popullsisë urbane si dhe problemet ekonomike dhe sociale që burojnë nga to, por edhe të ardhmen jo fort të ndritshme që tërë këto zhvillime po na e projektojnë, ideja mbizotëruese në të cilën duket se të gjithë kërkojnë shpëtimështë ajo që përmblidhet brenda nocionit të qëndrueshmërisë. Qyteti sipas Aristotelit, (...) rrjedh prej nevojave themelore të njerëzve dhe vazhdon të ekzistojë për hir të nevojës për jetë më të mirë. Ndërsa, qëndrueshmëria si paradigmë, sipas urbanistes Nan Ellin, është në linjë me qasjen e bazuar në nevojat (e komunitetit), meqë ajo fillon me identifikimin e tyre dhe problemeve, si dhe pastaj propozon zgjidhje, vendos qëllime dhe përpinqet t'i implementojë ato<sup>16</sup>. Andaj, një qytet si e mirë e përbashkët, që mëton zhvillim të qëndrueshëm, ngrihet nga një shoqëri gjithëpërfshirëse përmes proceseve pjesëmarrëse. Ai, sipas David Harvey-t, mbështet zhvillimin e plotë të potencialit dhe aftësive njerëzore dhe është për të gjithë, meqë bazohet në nevojat e tyre, si dhe ndërtohet nga të gjithë duke u bazuar në aftësitë (mundësitë) e tyre<sup>17</sup>.

<sup>15</sup> <http://gjs.appstate.edu/social-justice-and-human-rights/what-social-justice>, qasur më 14.11.2014, ora 21:00

<sup>16</sup> Ellin, N., Good Urbanism – Six Steps to Creating Prosperous Places, fq. 33, IslandPress, Washington, 2013 (Amazon Kindle edition)

<sup>17</sup> Harvey, D., The Right to the City, New Left Review 53, <http://newleftreview.org/II/53/david-harvey>

Në shoqëritë demokratike presim që zëri i secilit të përfaqësohet në proceset e vendimmarrjes për qytetin nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në kuvendet dhe këshillat e qytetit. Në realitet këta përfaqësues në të shumtën e rasteve nuk e përfaqësojnë zërin e grupeve të marginalizuara, të cilat, sipas A. Madanipour, nuk kanë qasje në burime financiare dhe janë jashtë proceseve politike<sup>18</sup>. Por, jo rrallë, gjithëpërfshirja në proceset vendimmarrëse, kontrollohet dhe ngushtohet nga grupime të caktuara politike, të cilat, për arsyet e interesave politike dhe ekonomik që i mbrojnë, për të siguruar kthimin e investimeve, por edhe për të lehtësuar proceset komerciale, dëshirojnë që të kenë ekskluzivitet në vendimmarrje në lidhje me qytetin, me çka i pengojnë grupimet e marginalizuara nga e drejta për zë në ndërtimin e politikave mbi qytetin dhe kontribuojnë në pabarazi të përgjithshme shoqërore.

Shumë probleme në qytetet kanë aspektin e vet hapësinor, por në të vërtetë origjinën e kanë në fushën e ekonomisë, sociale dhe politike<sup>19</sup>. Ekskluzivitetin për ta prodhuar qytetin që praktikat e deritanishme institucionale ia dhurojnë grupimeve të ngushta të interesit ekonomik që kanë përfaqësim të fortë politik në këshillat komunal, paraqet barrierën kryesore me të cilën duhet të ballafaqohen grupet e marginalizuara. Këto bariera në përditshmëri

[harvey-the-right-to-the-city](#), qasur më 16.12.2014, në ora 16:00

<sup>18</sup> Madanipour, A., Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development, Madanipur, A., ed., Routledge, New York, 2010, Amazon Kindle edition

<sup>19</sup> Marcuse, P., Kapitulli 3, Whose Right(s) to what City?, Cities for People not for Profit: Critical Urban Theory and the Right to the City, ed. Brenner, N., Marcuse, P., Mayer, M., Routledge, New York, 2012, Amazon Kindle edition.

paraqiten si barriera fizike në mjedis urban, barriera në mundësitë në integrim në treg, në shoqëri civile, arsim, kulturë, etj. Kur flasim për mjedisin fizik, si pasojë e praktikës aktuale të vendimmarrjes në këshillat komunale, që siç u tha më lartë, shpeshherë merren falë përfaqësimit të fortë politik të interesave ekonomik të grupeve të ndryshme, hapësira e qytetit vazhdon të zhvillohet duke i dhënë prioritet nevojave të “të fuqishmëve” – atyre prapa timonit të makinës, duke i mospërfillur nevojat e këmbësorëve dhe atyre që fizikisht janë më të dobët, më të shkurtër, më të ngadalshëm, që përdorin ndihmesa për të lëvizur, që kujdesen për fëmijë, apo për të moshuar, etj. E njëjta, i jep industriisë së ndërtimit përparësi që ta dendë hapësirën e qytetit, për pa menduar fare për hapësirat publike, gjelbërimin, parqet dhe përbajtjet e tjera publike, që si të mira të përbashkëta janë vende me të cilat njerëzit e ndryshëm lidhin identitetin e tyre dhe ndihmojnë gjallërimin e shoqërisë përmes veprimeve kolektive<sup>20</sup>.

Jeta ideale në qytet, sipas Iris Marion Youngut (1990), duhet të përfaqësohet nga një mjedis, që është i gatshëm të pranojë dallimet individuale dhe grupore të popullatës, si dhe të mbështesë shumëlojshmërinë e aktiviteteve dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike<sup>21</sup>. Promovimi i drejtësisë sociale në qytet, ‘paraqet vendosjen e mekanizmave institucionalë (...) për të njojur pozitivisht dhe konfirmuar grupet e ndryshme sociale dhe (...) karakteristikat e tyre dalluese’. Kjo politikë, në

një situatë ideale, më parë vlerëson dallimin dhe diversitetin sesa ngashmërinë<sup>22</sup>.

Në përmbyllje të kësaj pjese, e rikujtojmë prapë Aristotelin: “qyteti përbëhet nga njerëz të ndryshëm; njerëz të ngashëm nuk mund të jetësojnë një qytet”<sup>23</sup>, për të theksuar se heterogeniteti dhe diversiteti janë tiparet themelore të qytetit dhe jetës urbanenë përgjithësi.

<sup>20</sup>Marcuse, P., kapitulli 3, *Whose Right(s) to what City?, Cities for People not for Profit: Critical Urban Theory and the Right to the City*, ed. Brenner, N., Marcuse, P., Mayer, M., Routledge, New York, 2012, Amazon Kindle edition.

<sup>21</sup> Marrë nga, Prince, M., J., *Inclusive City Life, Persons with Disability and Politics of Difference*, *Disability Studies Quarterly*, Vol. 28, n.1, <http://dsq-sds.org/article/view/65/65>, qasur më 16.12.2014, në ora 20:00

<sup>22</sup>Po aty

<sup>23</sup>Aristoteli, *Politika*, libri i parë, marrë nga Sennet, R., *Flesh and Stone*, fq, 2

### III. Projekti për planifikim me pjesëmarrje

“Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është projekt trevjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Projekti përkrahet nga Olof Palme International Center dhe ka filluar së zbatuari në muajin janar 2013. Grupet e komunitetit me të cilat po punohet në këtë projekt janë: gratë, të moshuarit, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisë. Me secilin grup të komunitetit, gjatë një viti të projektit organizohen katër fokus grupe dhe një debat publik, ndërsa paralelisht do të zhvillohet procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtoreni e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkeseve të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Planifikimi urban në Kosovë është një aktivitet teknik dhe i udhëhequr nga ekspertët, që kryesisht bazohet në të dhënat ekzistuese dhe ka pak ndërlidhje me mjedisin (kontekstin) për të cilin hartohet. Kjo praktikë kryesisht prodhon plane që janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale dhe për më tepër, ajo nuk e reflekton realitetin në terren, me ç'rast qytetarët nuk kanë ndjenjë përkatësie. Pjesëmarrja e qytetarëve kufizohet brenda një periudhe të caktuar disaditore dhe kryesisht disa ditë para miratimit përfundimtar të planeve. Ekziston një nevojë imanente për përfshirjen e interesave dhe aspiratave që qytetarëve në planet urbane, e sidomos të atyre grupeve që jetojnë janë të privuara nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve është qenësore që planet urbane të janë

relevante dhe të zbatueshme. Planifikimi urban gjithëpërfshirës ndihmon edhe procesin e demokracisë lokale, duke inkurajuar përfshirjen qytetarë në të gjitha nivelet e procesit. Kjo qasje e re e urbanizmit (Urbanizmi i Ri) sfidon modelin aktual në Kosovë (planifikimin socialist të qyteteve), i cili ofron shumë pak hapësirë për qytetarin.

Projekti do të synojë përbushjen e këtyre objektivave specifikë: [a] Ta zhvillojë metodologji dhe qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin urban, [b] Ta sigurojë lidhjen e munguar mes qytetarëve dhe planerëve urbanë, [c] Ta zhvillojë ndjenjën e përkatësisë së qytetarëve për mjedisin rrethues të jetesës, [d] T'i përkthejë interesat dhe nevojat e qytetarëve në plane të zbatueshme urbane, [e] Ta inkurajojë pjesëmarrjen aktive të grupeve të disfavorshme dhe të marginalizuara të shoqërisë, [f] Ta promovojë qasjen e integruar të planifikimit urban (social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor).

Kjo analizë përbledh të gjeturat dhe ofron rekomandime bazuar në anketën e tretë të projektit me mostër të gjerë në Prizren. Gjatë këtij viti, në kuadër të projektit janë realizuar: 14 fokus grupe me shtatë grupe të komunitetit, 5 iniciativa/performanca publike me qëllime avokimi (iniciativa komunitare), 7 debate, anketim me qytetarë të Prizrenit mbi planifikimin urban, 7 raporte dhe një konferencë. Vitin e kaluar u nënshkrua edhe Memorandum i Bashkëpunimit me Drejtoren e Urbanizmit. Në pjesën e fundit të vitit, këto raporte do t'i dorëzohen komunës së Prizrenit dhe do të fillojë fazë e avokimit për përfshirjen e shqetësimeve dhe nevojave të qytetarëve në planet urbane të komunës.

#### IV. Metodologjia e hulumtimit me popullatën e përgjithshme

Mostra për studimin e tretë për çështjen e urbanizmit të zhvilluar gjatë muajit qershor 2014, është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, duke e përzgjedhur çdo të tretën shtëpi. Si fillim janë zgjedhur 41 lagje dhe paralagje ne qytet që kanë siguruar përfshirjen sa më të gjerë gjeografike të qytetit. Respondentët janë përzgjedhur duke përdorur muajin e lindjes pasi që 12 muajt e vitit janë distribuuar në mënyrë proporcionale në pyetësorët e përdorur për hulumtim.

#### V. Rezultatet


Sekzioni i rezultateve është i organizuar sipas mostrës pjesa e parë paraqet rezultatet për mostrën e randomizuar dhe tjetra për mostrën me grupe të ndryshme të interesit

#### Karakteristikat e mostrës

Nga popullata e përgjithshme kanë marrë pjesë 300 respondentë ku 54.7% (n=164) kanë qenë të gjinisë femërore dhe 45% (n=135) të gjinisë mashkulllore, si dhe 1 person nuk e ka deklaruar gjininë 0.3%. Për sa i përket moshës 27% e mostrës kanë qenë në grup moshën 16-25 vjeçar, 62% kanë qenë të moshës 26-64 vjeçare si dhe 10% kanë qenë mbi 65 vjeç, 3 persona nuk e kanë deklaruar moshën e tyre, apo 1%.


Për sa i përket etnisë të respondentëve 85.3% e mostrës ishin shqiptarë, 1% e komunitetit RAE, 6.7% e komunitetit turk, boshnjak 5.3% si dhe serb 0.7%.

Figura 1- Statusi i punësimit me përqindje




31.3% e të intervistuarve kanë raportuar të janë të punësuar, 21.0% janë amvise, 16.3% janë studentë ose mësojnë ndonjë zanat, 8.3% e tyre janë pensionistë, 19.7% janë të papunë si dhe 2.7% e tyre janë të papunë, por që nuk kërkojnë punë.

Figura 2 - A keni njohuri/informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plane urbane?



Në këtë hulumtim shihet se 50.3% e respondentëve kanë deklaruar se kanë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.


Figura 3 - Nga e keni marrë informatën mbi atë se Prizreni ka plan urban?



Në këtë hulumtim nga 151 (50.3%) respondentë që kanë deklaruar se kanë

njohuri për atë se Prizreni ka plan urbanistik, 35.0% e tyre kanë dëgjuar nga mediet, 10.3% nga të afërmit si dhe 4.0% nga të tjerët.


*Figura 4 - A keni informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin?*



$\chi^2(12,300)=4.061, p<.970$

Në hulumtimin e tretë me radhë meshkujt kanë raportuar në përqindje më të lartë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në përqindje prej 39.3%, ndërsa nga ana tjetër 31.7% e femrave kanë raportuar se kanë informatë në lidhje me këtë çështje. Analiza statistikore e hi katorrit tregon se nuk ka dallime sinjifikante në aspektin gjinor dhe nëse kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin.


*Figura 5 - Nëse kanë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në raport me etninë.*



$\chi^2(12,300)=4.061, p<.970$


Për dallim nga raportet e tjera boshnjakët kanë raportuar në nivel më të lartë se kanë dijeni qe mund te marrin pjesë në diskutime publike të planeve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin me një përqindje prej 37.5 %, më pas janë shqiptarët me 35.5%, nga figura e mësipërme mund të vërehet se ka dallime të vogla në mes të etnive. Analiza e hi katorrit rezulton se nuk ka dallime sinjifikante në mes të etnive në njohurinë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin.

*Figura 6 – Nëse kanë marrë pjesë në debatet publike të organizuar nga komuna*




Nga përqindja e përgjithshme prej personave që kanë njohuri për organizimin e debateve publike, vetëm 1.3% kanë deklaruar që kanë marrë pjesë, 38.3% kanë raportuar që nuk kanë marrë pjesë si dhe 60.3 % kanë qenë pa përgjigje (në këtë përqindje përfshihen edhe ata që kanë thënë se nuk kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin).

*Figura 7 - Si i artikuloni nevojat tuaja në raport me organet komunale?*



Në këtë hulumtim pjesa më e madhe e respondentëve apo 61.7% kanë thënë se personalisht kontaktjnë me organet komunale, 7.7% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme, 4.7% e tyre nuk e din se si ti artikulojnë nevojat që i kanë, si dhe 4.0% e tyre kanë forma të tjera të komunikimit me organet komunale.


Figura 8 - A jeni ftuar në ndonjë debat publik nga organet komunale?



Në pyetjen se a kanë qenë të ftuar ne ndonjë debat publik 11.0% e popullatës kanë marrë ftesë nga organet komunale, për dallim nga 87.3% e tyre që nuk kanë qenë të ftuar.

Nga ata që kanë marrë ftesë vetëm 5.0% e tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë ftuar. Nga popullata e përgjithshme, personat të cilët kanë marrë pjesë nëpër debate publike kanë biseduar për çështjet të ndryshme siç janë: ambienti, hartimi i planit të ri urbanistik, kanalizimi dhe asfaltimi i lagjes, projektet e Kryqit të kuq për Prizren, për banesat e lagjes si dhe për rregullimin e planit hapësinor.

Figura 9 - A jeni ftuar në ndonjë debat publik nga shoqëria civile/organizatat joqeveritare




Respondentët kanë deklaruar me një përqindje prej 19.30 % që janë ftuar për të marrë pjesë në debate të organizuara nga OJQ apo shoqëria civile për ndonjë debat të caktuar.

Nga ata që kanë marrë ftesa 10.7% e tyre kanë marrë pjesë në takimet për të cilat janë thirrur.


Nga organizatat që kanë marrë pjesë në debate publike, çështjet të cilat janë diskutuar janë si: infrastruktura, buxheti për persona me aftësi të kufizuara, për planet e veprimit për romët, për planifikim të buxhetit, kornizat afatmesme të buxhetit, për arsim/edukim, për ndriçimin publik, për planifikimin urbanistik, për raste sociale, për rregullimin e qytetit, për varrezat-kompleksi Landovicë, rregullimi i shkallëve ne Kala, rregullimi i ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit, rregullorja për vullnetarizëm, për sportin, për të drejtat e grave dhe barazi gjinore, si dhe për trashëgiminë kulturore.

Figura 10 - Përqindja e qytetarëve të Prizreni aktiv apo jo aktiv në organizata të ndryshme



Përqindja më e madhe e qytetarëve aktiv në organizata ka rezultuar të jetë kështu: parti politike me 10%, organizatat sportive dhe rekreative me 8.0% si dhe të pasuar nga organizatat e artit, kulturës dhe arsimit me 7.0%, 6.7% organizata fetare. Grafikoni i mësipërm paraqet përqindjen e respondentëve që janë anëtarë aktiv apo jo aktiv në organizata të ndryshme.


Figura 11 - Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve



Në këtë hulumtim qytetarët u janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizmit dhe të qytetit, ku iu është kërkuar që ti zgjedhin 4 opsione nga ato që sipas tyre janë më të rëndësishme për tu adresuar.. Analiza është bërë për të gjitha opsonet ku si problem i parë është paraqitur bllokimi i trottuarave me makina me një përqindje prej 72.4, e përcjellë nga ndërtimet pa leje me 44%, më pas mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 42%, me 18.6% janë problemet me infrastrukturë (kanalizimi dhe ujësjellësi), mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve është e 18.3% si dhe çerdhet për


fëmijë me 17.6%. Problemi i bllokimit të trottuarave ka qenë edhe problem i rëndësishëm i identifikuar nga respondentët edhe në dy hulumtimet paraprake. Grafikoni i mësipërm tregon përqindjen për të gjitha çështjet e parashtruara për mostrën në tërësi të qytetarëve.

Figura 12 - Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve të gjinisë mashkullore të Prizrenit



Respondentët meshkujnë mostrën e përgjithshme duhet të zgjidhnin 4 çështje kryesore më problematike për qytetin e Prizrenit, ku me një përqindje prej 74% deklaruan se problem i parë është bllokimi i trottuarave me makina, e dyta ndërtimet pa leje me 51.8%, e treta mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 36.3% si dhe e katërtë mungesa e hapësirave rekreative dhe sportive.


Figura 13- Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve të gjinisë femërore të Prizrenit



Gratë respondente në mostrën e përgjithshme duhet të zgjidhnin 4 çështje kryesore për


adresim në organet kompetente, ku me një përqindje prej 71.4% prin bllokimi i trotuareve me makina, si e dyta radhiten ndërtimet pa leje me 37.2%, e treta është mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 31.7% si dhe e katërtë është mungesa e parqeve publike me 23.7%.

*Figura 14 - Çështjet kryesore sipas pensionistëve në kuadër të mostrës së përgjithshme*




Duke e marrë parasysh se 10% e mostrës ishin mbi moshën 65 vjeçare, atëherë pensionistët duhet të zgjidhnin tri çështje kryesore që i shihnin si problematike në qytetin e Prizrenit. Me një përqindje prej 76% ishte mungesa e vend takimeve pér pensionistë/hapësira rekreative, e dyta me 44% ishte bllokimi i trotuareve me makina si dhe e treta ishte qasja në institucionet shëndetësore me një përqindje prej 44%.

*Figura 15 - Çështjet kryesore sipas grave mbi moshën 28 vjeçare në kuadër të mostrës së përgjithshme me pyetje të veçanta pér këtë popullatë*



Nga mostra e përgjithshme, por me pyetje të veçanta pér këtë popullatë iu shtruan disa pyetjeve pér t'i zgjedhur 3 çështje kryesore si më problematike, ku sipas tyre me një përqindje prej 50 zgjodhën bllokimi i trotuareve me makina, e dyta me radhë me 47.2% ishte siguria në rrugë dhe e treta mungesa e hapësirave të gjelbëruara me 26.9%. Vlen të përmendet se në pyetjen e veçantë se cilat janë çështjet e sigurisë në rrugë që e shqetëson këtë popullatë në më se 80% të rasteve është përmendor makinat dhe vozitja e shpejtë në qytet.


*Figura 16 - Çështjet kryesore sipas të rinjve në kuadër të mostrës së përgjithshme me pyetje të veçanta pér këtë popullatë*



Të rinjtë nga mostra e përgjithshme me pyetje të veçanta duhet të zgjidhnin 3 çështje kryesore si më problematike pér ta. Ku e para radhitet mungesa e hapësirave rekreative me një përqindje prej 48.4%, e përcjellë nga bllokimi i trotuareve me makina me 41.8% si dhe e treta është mungesa e hapësirave kulturore pér koncert/kinema me 35.2%.

Një pyetje tjeter i ka pyetur të gjithë respondentët se sa janë të kënaqur me punën e komunës në çështje të caktuara dhe iu është kërkuar të vlerësojnë prej 1 deri në 10. Më poshtë është paraqitur mesatarja e pikëve pér secilën çështje. Pikët e ulëta paraqesin kënaqshmëri të ultë dhe pikët më të larta paraqesin kënaqshmëri më të lartë.

*Figura 17 - Mesatarja e kënaqshmërisë prej 1-10 për çështje të ndryshme për gjithë mostrën*



Nga këto rezultate shihen se në nivel më të lartë të kënaqshmërisë ka me furnizimin me ujë 7.2, pasuar nga kanalizimi 6.8, 6.6 me transportin publik, 6.6 me ndriçimin publik dhe 6 me mirëmbajtjen e rrugëve.


Ndërsa niveli i ulët i kënaqshmërisë bie mbi çështjet si: ndërtimet pa leje 2.1, mundësia e ofruar për qarkullimin e personave me aftësi të kufizuar 2.4, ndërtimet e larta në qytet 2.8, me mirëmbajtjen e trotuareve për parkim, 2.8 dhe me 3.2 mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.

### Hulumtimi me organizata dhe grupe të caktuara të komunitetit

Në këtë hulumtim janë zhvilluar 100 intervista me këto popullata: përfaqësues të OJQ si DOKUFEST, EC Ma Ndryshe, ATTA, CHwB, Dora-Dorës, FFAK, Green Art, Handikos-i, Old Timers Club, Grua Bashkëkohore, Orkestra e Qytetit, Shoqata e të Verbërve, Shoqata e të Shurdhërve, Ura e Artit, X40, Durmish Asllano, FFAK, Fonadacioni Legatum, THY, SHKA Agimi, NGOM fest, Leos Art Organization, SH.B.Sharri, ISDY, K.B.Marsi, PETEK, Shoqata e Bjeshkatareve 'Haxhi Beda', Qendra për asistencë mjedisore 'PELLGU', OPDMK, KDI, FINCH, Shkolla Lef-Nosi, Sharski Behari, QRTK, përfaqësues të organizatave studentore, të rinj në biznes, persona me asistencë sociale.


Gjithashtu janë përfshire edhe gratë kryefamiljare si dhe gratë në politike. Përpos tyre, pjesëmarrës kanë qenë edhe nga drejtori të ndryshme të komunës si: drejtoria e shëndetësisë, drejtoria për mirëqenie sociale, drejtoria e kulturës si dhe drejtoria për zhvillim ekonomik.

*Figura 18 – Problematikat kryesore sipas organizatave kulturore dhe përfaqësues të organizatave kulturore*



Nga rezultatet me organizatat kulturore shihet se katër çështjet më shqetësuese për ata janë 34.1% ndërtimet e larta në qytet, 30.3% mungesa e hapësirave kulturore për të rinj, 30% bllokimi i trotuareve me makina, 26.1% shkatërrimi i qendrës historike në Prizren dhe me 25.8% ndërtimet pa leje.


*Figura 19 – Çështjet kryesore sipas përfaqësuesve të organizatave mjedisore*



Në këtë hulumtim janë intervistuar 11 përfaqësues të organizatave mjedisore (në ndonjë organizatë janë intervistuar edhe nga dy anëtarë) është gjetur si problem kryesor i


urbanizmit të jetë me 59.4% shkatërrimi i qendrës historike të qytetit, 34.1% ndërtimet e larta në qytet, 32.5% ndërtimet pa leje dhe katërtë ndotja e mjedisit (ajrit dhe lumit) me 31.1%.

Figura 20 – Çështjet kryesore problematike sipas personave me aftësi të kufizuara (grupeve të ndryshme)



Sipas përfaqësuesve nga organizatat për persona me aftësi të kufizuara të cilët u intervistuan 23 prej tyre, u pa që 4 çështjet kryesore që i rangojnë janë, me 66.7% radhitet bllokimi i trotuareve me makina, më pas me përqindjeradhiten dy çështje si mungesa e lidhjeve të transportit publik. me 33.4%, e treta mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve dhe me të njëjtën përqindja u përmendën problemet e qarkullimit përmes personave me aftësi të kufizuara.


Figura 21 – Çështjet kryesore problematike sipas personave janë përfitues të asistencës sociale



Në total janë intervistuar 8 respondentë që janë përfitues të asistencës sociale si problem të parë kanë përmendur mungesën e


objekteve të mjekësisë familjare me 38%, bllokimin e trotuareve me makina, dhe me të njëjtën përqindje 37.5 mungesën e çerdheve përmes fëmijëve.

Figura 22 – Çështjet kryesore problematike sipas drejtoreve në nivelin komunal



Problem kryesor përmes 6 drejtoreve komunale del të jetë bllokimi i trotuareve me makina me 83.3% duke u pasuar me 50.1% me ndërtimet pa leje dhe si çështje të tretë dhe të katërt me të njëjtën përqindje 33.4% është identifikuar mungesa e parqeve publike dhe mbingarkesa e shkollave me ndërrime.

Figura 23 – Çështjet kryesore problematike përmes gjithë mostrën e OJQ-ve dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit



Si çështje kryesore me këtë popullatë u identifikua të jetë ndotja e mjedisit (ajri dhe lumi) me 48.1%, e pasuar nga shkatërrimi i qendrës historike me 46.1% e treta mungesa e një plani të qëndrueshmër përmes zhvillimit mjedor me 33.5% dhe e katërtë bllokimi i trotuareve me makina me 32.9%. Grafikoni i

mësipërm paraqet përqindjet edhe për çështjet e tjera.

#### IV. Konkluzion

##### Krahasimi i rezultateve të tre anketimeve të kryera në vitin 2013 dhe 2014

Në përgjithësi, rezultatet e anketimit të tretë, në kuadër të analizës për qytetin gjithëpërfshirës, i konfirmojnë dhe i përforcojnë të gjeturat e analizës së parë dhe të dytë (2013). Qytetarët e intervistuar shprehen jaftëzakonisht të pakënaqur me menaxhimin e qytetit nga komuna e Prizrenit. Kjo është e dukshme nga numërimi i brengave dhe problemet e mëdha të identifikuara dhe të ilustruara në grafikonet që përbledhin rezultatet e anketimit të dytë. Si probleme kritike vazhdojnë të jetë qasja dhe lëvizja në qytet për të gjithë qytetarët pavarësisht moshës, gjinisë dhe aftësisë, por edhe mungesa e hapësirave/objekteve publike që do të mundësonin pjesëtarët e intervistuar nga grupe të ndryshme të interesit që ta shfrytëzonin në mënyrë më të efektshme qytetin.

Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve të Prizrenit:

##### Trotuaret e zaptuara

Fig. 24-Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve të Prizrenit - Anketimi i parë, qershori 2013






Fig. 25. Problemet kryesore të urbanizmit në qytet sipas qytetarëve të Prizrenit - Anketimi i dytë, shtator 2013



##### Anketimi i parë:

1. 63.1% - bllokimi i trotuareve me makina,
2. 42.6% - mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit
3. 35% - ndërtimet pa leje

##### Anketimi i dytë

1. 64.3% - bllokimi i trotuareve me makina,
2. 44% - ndërtimet pa leje,
3. 41.8% - mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit

##### Anketimi i tretë

1. 72.4% - bllokimi i trotuareve me makina me një përqindje prej,
2. 44% - ndërtimet pa leje,
3. 42% - mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet.

Sikurse në analizën e parë ashtu edhe tash vërehet një brengë e konsiderueshme e qytetarëve më pengesat që atyre iu paraqiten gjatë lëvizjes në qytet

Të ecësh prej një pjese në pjesën tjeter të qytetit është një nga tiparet kryesore të njeriut. Shfrytëzimi i këmbëve tona për të na dërguar gjithandjej është një nga funksionet themelore të llojit tonë.

Në shumë vise të botës këmbësorët janë të marginalizuar aq shumë sa që të ushtrosh këtë veprim themelor njerëzor është bërë mjaft e rrezikshme.<sup>24</sup>Kjo është evidente edhe në qytetin e Prizrenit. Bllokimi i trotuareve, qoftë me makina të parkuara, mall të ekspozuar para lokaleve, borë e papastruar, pengesa në forma të ndryshme (reklama, vazo me lule, shtyllëza, etj), por edhe sipërfaqe e dëmtuar e trotuareve që vështirësojnë/ pengojnë pjesërisht por edhe plotësisht përgrupe të caktuara ecjen. Shumë prej këmbësorëve, për t'iu bërë bisht këtyre pengesave, dalin e ecin në rrugën e dedikuar për automjete, me ç'rast e ekspozojnë veten rrezikut nga aksidentet.

E drejta për “të dalë në rrugë” nënkupton lirinë shprehjes dhe demokracinë.<sup>25</sup>

Nëse trotuarin e shohim si një sferë publike dhe politike, barrierat për një lëvizje të lirë për të gjithë qytetarët, pavarësisht aftësisë, statusit ekonomik, racës, gjinisë, besimit duhet të shihen si pengesa të një

pjesëmarrjeje të mirëfilltë të tyre në shoqëri dhe në jetën politike.<sup>26</sup>

### Rekomandime

Për të mos u vështirësuar shfrytëzimi i trotuareve nga ana e qytetarëve, i rekomandohet Komunës së Prizrenit që:

- Të largojë të gjitha strukturat e ndërtuara (shkallë, plato dhe të ngjashme) përpara lokaleve, që me gabaritin e tyre ngushtojnë në masë kritike hapësirën për lëvizje të këmbësorëve,
- Të largojë vazot e betonit, pengesat e tjera, reklamat, mallin i ekspozuar para lokaleve,
- Të largojë mobiliarin përpara lokaleve shërbyese në hapësira publike, aty ku ngushtohet kalimi i lirë të këmbësorëve,
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, të pengohet parkimi i veturave në trotuarë dhe sipërfaqe të tjera të dedikuara për lëvizjen e këmbësorëve,

### **Pjesëmarrja qytetare në diskutime publike dhe informimi**

Edhe pse e dëshmuar tashmë në dy anketimet paraprake, anketimi i fundit vetëm se e përforcon atë që është shënuar një vit më herët: komuna e Prizrenit nuk ka arritur të krijojë mekanizma për të informuar, ftuar dhe mobilizuar qytetarët e vet për të marrë pjesë në diskutimet publike. Vazhdon të jetë një numër i madh i tyre (në veçanti gra dhe pjesëtarë të komuniteteve më të marginalizuara) që nuk e kanë fare informatën se mund të kontribuojnë në

<sup>24</sup> Goodyear, S., Is Being Able to Walk Around Your City a Right?<http://www.citylab.com/commute/2013/07/being-able-walk-around-your-city-right/6121/>, qasur më 20.12.2014, ora 14:00

<sup>25</sup> Loukaitou-Sideris, Anastasia, Sidewalks: Conflict and Negotiation over Public Space (Urban and Industrial Environments, The MIT Press; 1 edition (May 29, 2009), Amazon Kindle edition

<sup>26</sup> EC Ma Ndryshe (Basha, R. Dhe Applicative Research Solutions), Analiza e dytë: Qyteti gjithëpërfshirës, nëntor 2013


procesin e planifikimit urban për lagjet e tyre në veçanti dhe qytetin në përgjithësi.

Të gjeturat e anketimit të fundit


- Gjysma e numrit të përgjithshëm të respondentëve kanë njojuri për ekzistimin e planeve urbane, ndërsa 1/3 e tyre informatat për to i marrin kryesisht prej medieve.
- Nga anketimi del në pah një përfshirje jashtëzakonisht e ulët e qytetarëve në debate, diskutime për projekte a çështje të tjera që kanë të bëjnë me qytetin e Prizrenit që organizohen nga komuna.
- Gratë janë më pak të informuarat rreth diskutimeve publike mbi çështjet urbanistike.
- Nga anketimi del se është një numër shumë i vogël i qytetarëve që ftohet në debate nga komuna por edhe nga shoqëria civile.

Rezultatet e mëposhtme pasqyrojnë krahasimin ndërmjet anketimeve të dy viteve të kaluara mbi çështjen e pjesëmarrjes qytetare në planifikim:


*Figura 27 - Nëse kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në raport me etnicitetin. – qershor 2013*




*Figura 28- Nëse kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në raport me etnicitetin. – shtator 2013*




*Figura 29- Nëse kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në raport me etnicitetin. – qershor 2014*




*Figura 30 - A keni informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin? - Qershor 2013*



*Figura 31 - A keni informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin? - Shtator 2013*



*Figura 32 - A keni informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin? - qershor 2014*



#### Anketimi i parë:

1. Meshkujt - 50.5% kanë informata që qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve urbane ndërsa vetëm 1/3 e femrave kanë raportuar se kanë informatë për këtë çështje. 42.6% - mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit
2. Shqiptarët kanë raportuar në nivel më të lartë se kanë dijeni se qytetarët mund të marrin pjesë në diskutime publike të planeve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në krahasim me etnicitetet e tjera.

#### Anketimi i dytë

1. 69.6% femra dhe meshkujt me 69.3% kanë informata që qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve urbane.
2. Shqiptarët kanë raportuar në nivel më të lartë se kanë dijeni se qytetarët mund të marrin pjesë në diskutime publike të planeve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në krahasim me etnicitetet e tjera në hulumtimin e parë.

#### Anketimi i tretë

1. 39.3% meshkuj dhe 31.7% të femrave kanë raportuar se kanë informata që qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve urbane.
2. Boshnjakët kanë raportuar në nivel më të lartë se kanë dijeni qe mund te marrin pjesë në diskutime publike të planeve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin me një përqindje prej 37.5 %, më pas janë shqiptarët me 35.5%, nga figura e mësipërme mund të vërehet se ka dallime të vogla në mes të etnive

#### Rekomandime

Në funksion të nxjerrjes së rekomandimeve, po e përsërisim thënien e A. Madanipour-it, sipas të cilit, qytetet duhet të ngrihen duke pasur parasysh parimin e barazisë dhe drejtësisë (...)duhet të jenë vende të qasshme, të krijuara dhe të menaxhuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse<sup>27</sup>, komponentë

<sup>27</sup>Madanipour, A., Kapitulli 12, Whose Public Space? në Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development,

thelbësore e së cilës janë pjesëmarrja qytetare. Për të siguruar një pjesëmarrje më të efektshme në këto procese, duhet të bëhet një fushatë më epërqendruar informimi. Përpos mënyrave të informimit që tashmë përdoren nga komuna (posterët, mediet, etj.), duhet të gjenden forma alternative të mobilizimit të qytetarëve, e në veçanti të anëtarëve të marginalizuar të komunititetit përmes OJQ-ve dhe shoqatave rreth të cilave organizohen këta qytetarë. Për të qenë sa më frytdhënëse këto diskutime, duhet të organizohen në njësi – fokus grupe të vogla diskutimi (p.sh. fokus grup i grave të bllokut, mëhallës, etj.) Grupet e vogla të diskutimit janë më lehtë të mblidhen dhe informohen, por edhe diskutimi më lehtë fasilitohen.

Në një proces gjithëpërfshirës të planifikimit, është më se e rëndësishme që krahas ekspertëve të fushës, të përfshihen edhe qytetarët jo-ekspertë, meqë qyteti popullohet nga qytetarë jo-ekspertë, të cilët, duke i njojur hallet e jetës së përditshme, mund të identifikojnë probleme dhe gjejnë zgjidhje më të përshtatshme në qytet.

#### **Format e organizimit të pjesëmarrjes qytetare në planifikimin e qytetit**

Më poshtë po japim një shembull të formave të organizimit të pjesëmarrjes qytetare në planifikimin e qytetit

#### Laboratorët e pjesëmarrjes qytetare<sup>28</sup>

(sipas Paola Michialino)

Laboratorët e pjesëmarrjes qytetare përfshijnë të gjitha stadet e projektit, nga konsultimet preliminare, diagnoza, përkufizimi i kritereve për secilin projekt, hapja konkursit për arkitektë për dizajnin e projekteve të veçanta, përzgjedhja e propozimeve të preferuara, deri te zbatimi i projekteve, etj.

Laboratorët e pjesëmarrjes qytetare duhet të përvetësojnë shtatë rregulla të lojës, të cilat duhet të përqafohen nga të gjithë pjesëmarrësit janë:

- (1) përfshirja vullnetare e banorëve, ekspertëve profesionalë, shërbysesve publik dhe përfaqësuesve të zgjedhur;
- (2) liria e shprehjes dhe pjesëmarrjes
- (3) njojja dhe pranimi i kompetencave të gjithë të përfshirëve;
- (4) koordinimi i brendshëm për te siguruar organizim, mobilizim të pjesëmarrësve dhe arkivimin e rregullt të regjistimeve dhe kujtesës së përvojës;
- (5) përfshirja e facilitatorëve të jashtëm, përgjegjës për ndërmjetësimin pedagogjik, teknik dhe politik;
- (6) zhvillimi i procesit të edukimit reciprok; dhe
- (7) krijimi i mjedisit kreativ për të gjeneruar propozime.

---

<sup>28</sup>Michialino, P., Kapitull 11, Co-production of publik space in Nord-Pas-de-Calais, në Madanipour, A., Whose Public Space?: International Case Studies in Urban Design and Development, Madanipour, A., ed., Routledge, New York, 2010, fq. 217, Amazon Kindle edition

## **EC Ma Ndryshe**

Organizata jo-qeveritare “EC Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përherershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2015), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rintjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Ku është kalldrëmi i Prizrenit (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit-zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërtë dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”,: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krashtsim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).